



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

**VENDIM**

**Nr. 5 Datë 21.01.2013**

**PËR**

**VENDOSJEN E SHOQERISE CEZ SHPERNDARJE SH.A, NE  
ADMINISTRIM TE PERKOHSHEM DHE EMËRIMIN E  
ADMINISTRATORIT TE SHOQERISE CEZ SHPERNDARJE SH.A.,  
NË ZBATIM TË VENDIMIT TE BORDIT TE KOMISIONERËVE TE  
ERE NR. 4, DATE 21 JANAR 2013, “PER HEQJEN E LICENCAVE  
PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES TE ENERGJISE ELEKTRIKE  
DHE AKTIVITETIT TE FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICE TE  
ENERGJISE ELEKTRIKE TE SHOQERISE CEZ SHPERNDARJE  
SH.A.”**

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 pika 4, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 13, të Rregullores për Procedurat e Heqjes së nje License, miratuar me vendimin nr. 68, datë 04.11.2005, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 4, date 21 janar 2013 “Për heqjen e licensave të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a, për aktivitetin e shpërndarjes së energjise elektrike, miratuar me vendimin nr. 08, date 25.01.2008, të ndryshuar, dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike” të miratuar me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 09, datë 25.01.2008, të ndryshuar”, Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-se nr. 1, date 10.01.2013 “Mbi procedurat e emerimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”, neni 4 i Rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me Vendimin nr. 1, date 10.01.2012, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.01.2013,

## Vendosi :

1. Venien ne administrim te perkohshem te shoqerise CEZ Shperndarje sh.a, sipas nenit 18, pika 4, germa c) e Ligjit 9072, date 22.05.2003, “Per sektorin e energjise elektrike”, te ndryshuar.
2. Gjate periudhes se perkohshme te administrimit pezullohen te gjitha pergjegjesite dhe kompetencat e organeve te shoqerise CEZ Shperndarje sh.a, si dhe te aksioneve te saj ne funksion te detyrimeve te licenses.
3. Te gjitha funksionet dhe kompetencat e administrimit te shoqerise CEZ Shperndarje sh.a, i kalojne administratorit te emeruar nga ana e Bordit te Komisionereve te ERE-se.
4. Emerimi i Z. Sahit DOLLAPI, si administrator i perkohshem i shoqerise CEZ Shperndarje sh.a, qe te operojë dhe mirembaje pajisjet, pasuritë dhe mjetet monetare dhe llogarite bankare te shoqerise.
5. Administratori i emeruar sipas pikes 4 te ketij Vendimi, ne administrimin e perditshem te shoqerise do zbatoje Rregulloren “Mbi procedurat e emerimit te administratorit dhe kompetencat e tij, ne zbatim te nenit 18, pika 4/c te Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike” si dhe ka keto detyra te menjehershme:
  - Të marrë menjëherë ne administrim Shoqerine CEZ Shperndarje sh.a.
  - Të ndryshojë vulën e shoqërisë. Vula e re të reflektojë vënien në administrim të shoqërisë.
  - Ne gjithe korrespondencen e shoqerise se vene ne administrim te perkohshem te reflektoje ndryshimet e ndodhura ne statusin e shoqerise.
  - Ndryshon rregullin e hyrjes në ndërtesat dhe në mjediset ku ruhen pasuritë, dokumentacioni, informacioni, pajisjet, përdorimi i të cilave dëmton interesat pasurorë të shoqerise Cez Shpërndarje sh.a, duke zëvendësuar kodet dhe fjalëkalimet, dhe duke vendosur kufizime të rrethit të personave që kanë të drejtë të hyjnë në këto mjedisë;

- Ndryshon ose krijon fjalëkalime të reja për hyrjet në rrjetin kompjuterik, duke lejuar hyrjen në të vetëm të punonjësve të autorizuar të shoqërisë Cez Shpërndarje sh.a;
  - Mund të ndryshojë kompetencat e personave, të cilët ushtrojnë veprimtari në emër dhe për llogari të Shoqërisë Cez Shpërndarje sh.a duke autorizuar për ushtrimin e këtyre kompetencave punëmarres të tjerë, dhe për këto ndryshime njofton palët e treta dhe Rregullatorin;
  - Ndjek menjëherë procedurat për ndalimin e pagesës së dividendëve, transferimit të kapitalit aksioner të shoqërisë Cez Shpërndarje sh.a, si dhe pagesën e administratorëve të shoqërisë Cez Shpërndarje sh.a, përveç shpërblimit për shërbimet që ata kanë bërë me parë.
6. Administratori i emëruar sipas pikës 4 të këtij Vendimi, nuk mund të transferojë asnjë aset ose pasuri materiale të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a, nëpërmjet shitjes, pengut, qerases, shkëmbimit apo formave të tjera.
7. Statusi i shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a, sipas këtij Vendimi dhe Administratori i emëruar sipas pikës 4 të këtij vendimi, behen publike nëpërmjet depozimit të këtij vendimi në QKR.
8. Depozitimi dhe publikimi i këtij Vendim në të dhënat e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a, me numër NIPT, K72410014H, do të realizohet sipas autorizimit bashkëlidhur këtij vendimi.
9. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë menjëherë administratorin e emëruar sipas pikës 4 të këtij Vendimi dhe shoqërinë CEZ Shpërndarje sh.a, për zbatimin e këtij Vendimi të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.